

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT FINAL

VLERËSIMI I NDËRMJETËM I PROJEKTIT “Përkrahja, mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe interesave të grave dhe vajzave”

zbatuar nga

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

28 gusht, 2014

Përgatitur nga by:

Elida Metaj, MA

Periudha e Vlerësimit:

26 maj 2014- 5 qershor 2014

Shënim: Ky vlerësim është mbështetur nga ADA (Agjencioni Austriak për Zhvillim). Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi e autores dhe nuk paraqesin pikëpamjet e ADA-s apo të ndonjë agjencioni tjetër.

Përmbledhje

Informata për projektin

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), rrjet i organizatave të shoqërisë civile për gratë i formuar që nga viti 2000, është mbështetur nga Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA) dhe bashkëfinancuar nga Kvinna till Kvinna (KtK) për programin dy vjeçar të titulluar “Përkrahja, mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe interesave të grave dhe vajzave”. Projekti është zbatuar nga dhjetori i vitit 2012 deri më dhjetorin e vitit 2014 me **objektivin** e përgjithshëm që *“të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave të përkrahen, mbrohen dhe promovohen në gjithë Kosovën”*. **Qëllimi** i projektit është që të rritet dhe përmirësohet pjesëmarrja e grave në proceset vendim-marrëse të këshillave komunale nëpërmjet (i) zhvillimit të kapaciteteve, (ii) pjesëmarrjes së anëtarëve të RrGGK-së në Fondin e Grave të Kosovës (FGK) dhe (iii) Grupet Avokuese të Grave (GAG).

Ndërsa projekti është në mes të zbatimit, para përfundimit të pritshëm të aktiviteteve në dhjetor 2014, RrGGK kontrakttoi një vlerësues të pavarur nga 26 maj 2014 – 5 qershor 2014 për të vlerësuar relevancën, efikasitetin, efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e projektit, mësimet e nxjerra, faktorët e suksesit, sfidat dhe paraqitjen e rekomandimeve për të informuar planifikimin për vazhdimin e mundshëm të projektit (FGK-së dhe GAG-ve) në 2015 dhe vazhdim.

Gjetjet Kryesore

Relevanca

Projekti vlerësohet si një ndërhyrje shumë relevante në kontekstin e zhvillimit të Kosovës. Hartimi dhe zbatimi i projektit u përgjigjen nevojave, vështirësive, prioritetëve të aktorëve, grupeve të interes dhe partnerëve të identifikuar nëpërmjet hulumtimeve që kanë evidentuar kryesisht: (i) financim të kufizuar për organizatat e shoqërisë civile të udhëhequra nga gratë, (ii) nevoja urgjente të grave të marginalizuara për shkak të etnicitetit,

aftësive të kufizuara, veçanërisht të atyre që jetojnë në zonat rurale, (iii) mangësi në kapacitetet institucionale në nivel qendror dhe lokal si dhe (iv) vështirësi financiare për zbatimin e Ligjit për Barazinë Gjinore dhe procesin e decentralizimit të qeverisë lokale.

Projekti është në përputhje me Planin Strategjik 2011-2014 të RrGGK-së dhe me Strategjinë e ADA-s për Kosovën 2013-2020 *për të reduktuar varfërinë nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social të zonave rurale, qeverisjes së mirë, barazisë gjinore dhe mbrojtjes së mjedisit.*

Efektiviteti

Projekti vlerësohet që ka bërë progres për të arritur rezultatet e pritshme dhe po ecën sipas planit për t'i arritur ato plotësisht deri në përfundimin e tij duke kontribuar në arritjen e objektivit të përgjithshëm dhe të qëllimit të projektit. Vlerësimi evidentoi (i) forcimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile veçanërisht në ciklin e menaxhimit të projektit, iniciativat avokuese, dhe ngritjen e fondeve (136 projekt propozime janë paraqitur në FGK dhe 42 janë financuar si dhe projekte të tjera të paraqitura dhe të financuara nga donatorë të tjerë), (ii) përmirësimin e cilësisë së projekt propozimeve nga thirrja në thirrje, (iii) pjesëmarrjen e grave të marginalizuara në vendim-marrje nëpërmjet zbatimit të granteve, (iv) GAG-e funksionale në 10 komuna me shkallë të ndryshme organizimi dhe funksionimi.

Projekti ka ofruar mundësi unike për të bashkuar gratë e marginalizuara, për t'i informuar për të drejtat e tyre, për t'i ndihmuar të kenë qasje në të drejtat e tyre dhe u ka dhënë zë për të kërkuar të drejtat e tyre dhe për të ndikuar në vendim-marrje.

Efikasiteti

Menaxhimi i fondeve të projektit vlerësohet efikas në lidhje me menaxhimin financiar (përdorimi i fondeve në raport me aktivitetet e planifikuara dhe rezultatet e pritshme), efikasitetin e brendshëm të menaxhimit të projektit dhe realizimin e planit të punës. Në fund të majit 2014 janë shpenzuar 41%

e fondeve të ADA-s dhe janë angazhuar 33% e tyre, që tregon se projekti është në përputhje me planin e realizimit të aktiviteteve dhe përdorimit të burimeve financiare siç është parashikuar në projekt dokument.

Projekti ka ngritur mekanizma të kontrollit të cilësisë që sigurojnë përdorim efektiv, efikas dhe korrekt të fondeve si Komiteti për Vlerësimin e Granteve (kontrolli i cilësisë së projekt propozimeve), vlerësim i rrezikut të përfituesve të granteve para nënshkrimit të kontratës dhe monitorimi i vazhdueshëm financiar i përfituesve të granteve nga ekipi i projektit.

Ndikimi

Projekti ka sjellë ndryshime të dukshme pozitive në (i) nivel individual (gratë janë fuqizuar rreth aftësi të reja, njohuri dhe informata për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave, me vetëbesim dhe vetëvlerësim më të lartë dhe qëndrime proaktive, (ii) në nivel organizativ (organizatat e shoqërisë civile kanë kapacitete të përmirësuara në menaxhimin e ciklit të projektit, zbatimin e projektit, raportimin narrativ dhe financiar, ngritjen e fondeve, prezantimin në publik, aftësi të marrëdhënieve me publikun si dhe përmirësim të proceseve dhe procedurave të brendshme nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimit, krijimin e sistemit financiar, përmirësim të komunikimit me përfituesit e tyre dhe publikun.

Qëndrueshmëria

Verësohet që rezultatet e arritura të projektit kanë shumë mundësi që të jenë të qëndrueshme pas përfundimit të projektit. Ka prova të besueshme të qëndrueshmërisë organizative të RrGGK-së, të anëtarëve të saj, fuqizim të përfituesve dhe ndërtim partneriteti me aktorët lokal për avancimin e të drejtave të grave.

Konkluzione dhe Rekomandime

RrGGK-ja është një organizatë e konsoliduar profesionalisht, me një rrjet të zgjeruar anëtarësh në nivel lokal dhe qëndror, me standarte të larta të transparencës dhe llogaridhënies, me një angazhim të njohur publik për çështjet e barazisë gjinore në Kosovë dhe me kapacitete të qëndrueshme

menaxhimi dhe udhëheqësie, që i mundësojnë të vazhdojë dhe zgjerojë FGK-në.

Rekomandohet në mënyrë të veçantë që RrGGK-ja duhet të kontaktojë donatorët që punojnë në Kosovë për t'iu bashkuar financimit të FGK-së të paktën për dy vitet e ardhshme (i) për të mbështetur dhe vazhduar rezultatet dhe sukseset e deritanishme të FGK-së në nivel lokal dhe t'i shtrijë në nivel kombëtar, (ii) t'u ofrojë mbështetje anëtareve të FGK-së për t'i shërbyer komunitetit të tyre, të adresojë çështjet dhe nevojat urgjente të grave në nivel lokal dhe qëndror si dhe të avancojë barazinë gjinore në Kosovë, (iii) t'i ofrojë mundësi RrGGK-së të forcojë FGK-në si strukturë dhe shërbim për anëtarët e saj dhe të zbatojë Strategjinë e Ngritjes së Fondeve për të diversifikuar burimet financiare të FGK-së, (iv) të ofrojë mbështetje për anëtarët e RrGGK-së dhe anëtarët e GAG-eve për të adresuar mangësitë në kapacitete të avokimit, prezantimit publik, hartimin e strategjive të avokimit, aftësitë në monitorim dhe vlerësim të shërbimeve komunale me lente gjinore, analizë me ndjeshmëri gjinore të buxheteve lokale dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.